

VENDIM
Nr.351, datë 6.3.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË
PROCEDURËS, PËR PAJISJEN, REFUZIMIN, RIPËRTËRITJEN DHE ANULIMIN E
LEJES SË PUNËS PËR VEPRIMTARI TË PAVARUR EKONOMIKE, SI I
VETËPUNËSUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 48 pika 3, 57, 67 pika 1, e 108, të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të huajt i jepet leje pune, e tipit B/VP, si i vetëpunësuar, për veprimtari të pavarur ekonomike, nëse plotëson kriteret, si më poshtë vijon:

a) Veprimtaria e tij ka përfitim ekonomik për zhvillimin e tregut të punës;

b) Veprimtaria është e përshtatshme në një sektor specifik, për rajonin gjeografik ku ajo do të ushtrohet, mbështetur në rezultatet e studimit të tregut të punës, nga zyra përkatëse e punësimit;

c) Ka hyrë në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Të huajt i ripërtërihet leja e punës, e tipit B/VP, si i vetëpunësuar, nëse:

a) veprimtaria ekonomike, që ai kryen, është në të njëjtat kushte, për të cilën i është dhënë leja e mëparshme, e tipit B/VP;

b) është me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Kërkesa për t'u pajisur me leje pune, të tipit B/VP, bëhet nga:

a) i huaji,

b) personi i autorizuar prej tij.

4. Personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, për t'u pajisur për herë të parë me leje pune të tipit B/VP, paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën me të dhënat personale, sipas formatit, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Statusin dhe aktin e themelimit të shoqërisë;

c) Autorizimin për personin e autorizuar prej tij;

ç) Kopjen e pasaportës;

d) Pesë fotografi.

5. I huaji, i cili kërkon ripërtëritjen e lejes së punës, të tipit B/VP, paraqet dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Kërkesën me të dhënat personale, sipas formatit, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Deklaratën personale, ku deklaron se vazhdon të zotërojë të njëjtën veprimtari ekonomike, për të cilin është pajisur me lejen e mëparshme, të tipit B/VP;

c) Autorizimin për personin e autorizuar prej tij;

ç) Pesë fotografi.

6. Personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, paraqesin kërkesën dhe dokumentacionin, e përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi:

a) në zyrën përkatëse të punësimit, në territorin e së cilës investitori do të ushtrojë veprimtarinë ekonomike, nëse është me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, nëse investitori do ta ushtrojë veprimtarinë ekonomike të tij në më shumë se një rajon gjeografik, nëse është me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) pranë përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e tij të origjinës.

7. Nëse kërkesa paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyrës përkatëse të punësimit, autoriteti, pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe vlerëson se ai nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 4 të këtij vendimi, i kërkon të huajit plotësimin e dokumentacionit, brenda 10 ditëve pune.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, nëse vlerëson se dokumentacioni i paraqitur është i plotë apo pas plotësimit të tij, brenda afatit të përcaktuar, është në rregull, vlerëson se përmbushen kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, dhe e pajis të huajin, brenda 10 ditëve pune, me leje pune, të tipit B/VP, për herë të parë.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit ia kthen kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur të huajit, nëse ai nuk e ka plotësuar atë brenda afatit të përcaktuar në pikën 7 të këtij vendimi.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit ia refuzon kërkesën për pajisje me leje pune, të tipit B/VP, të huajit, i cili, megjithëse ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar, vlerësohet se nuk plotëson kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi ose është në kushtet e përcaktuara në pikën 21 të këtij vendimi.

11. Nëse kërkesa është paraqitur pranë përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e origjinës së të huajit, ajo, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, e përcjell dokumentacionin e paraqitur pranë saj në drejtorinë, që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

12. Drejtoria, që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, e përcjell dokumentacionin e paraqitur në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyrën përkatëse të punësimit, sipas kompetencës territoriale, që ato kanë.

13. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, për pajisjen/refuzimin të huajit me leje pune të tipit B/VP, ndjekin procedurat e përcaktuara në pikat 7, 8, 9 e 10 të këtij vendimi.

14. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, nëpërmjet drejtorisë, që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, përcjell në Ministrinë e Punëve të Jashtme njoftimin për pajisjen/refuzimin e lejes së punës, të tipit B/VP.

15. Ministria e Punëve të Jashtme njofton përfaqësinë diplomatike të Republikës Shqipërisë, në vendin e origjinës së të huajit, për pajisjen/refuzimin e lejes së punës, të tipit B/VP.

16. Personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, për ripërtëritjen e lejes së punës, të tipit B/VP, paraqesin, 15 ditë para mbarimit të afatit të lejes ekzistuese, dokumentacionin e përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi:

a) në zyrën përkatëse të punësimit, në territorin e së cilës i huaji do ta ushtrojë veprimtarinë ekonomike, nëse është me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, nëse i huaji do ta ushtrojë veprimtarinë ekonomike në më shumë se një rajon gjeografik, nëse është me qëndrim të ligjshëm, në territorin e Republikës së Shqipërisë.

17. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar ta Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, pas paraqitjes së kërkesës nga investitori, për ripërtëritjen e lejes së punës, të tipit B/VP:

a) verifikon shlyerjen e detyrimeve në organet tatimore, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, të punëdhënësit, ku ai është i vetëpunësuar;

b) kërkon nga drejtoritë rajonale të inspektimit në punë/zyrat vendore të inspektimit në punë një vlerësim, nëse i vetëpunësuarit ka zbatuar legjislacionin e punës, për periudhën e vlefshmërisë së lejes së mëparshme të punës, të tipit B/VP, ose ka shlyer shkeljet e konstatuara në aktin e fundit të inspektimit në punë.

18. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, për ripërtëritjen e lejes së punës, të tipit B/VP, apo refuzimin e saj, brenda një periudhe prej 30 ditësh pune, ndjek procedurat e parashikuara në pikat 7, 8, 9, 10 e 17 të këtij vendimi, ndërsa për kriteret dhe dokumentacionin, vlerësimi do të bëhet sipas përcaktimeve në pikat 2, 5 e 17 të këtij vendimi.

19. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit për ripërtëritjen e lejes së punës, të tipit B/VP, apo refuzimin e saj për të huajt, të cilët kanë përfituar leje pune, sipas ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 “Për të huajt”, ndjek procedurat e parashikuara në pikat 7, 8, 9, 10 e 17 të këtij vendimi, ndërsa për kriteret dhe dokumentacionin, vlerësimi do të bëhet sipas përcaktimeve në pikat 2 e 5 të këtij vendimi.

Afati i vlefshmërisë së lejes së punës së ripërtëritur, të tipit B/VP, të jetë në përputhje me përcaktimet e nenit 106 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, për kategorinë, së cilës i përket i huaji.

20. Zyra përkatëse e punësimit, pas paraqitjes së kërkesës për ripërtëritjen e lejes së mëparshme të punës, të tipit B/VP, e pajis të huajin me dokumentin zëvendësues të lejes së punës, sipas përcaktimeve të nenit 46 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”.

21. Të huajit i refuzohet lëshimi i lejes së punës, e tipit B/VP, apo ripërtëritja e saj edhe nëse vërtetohet njëra nga situatat e përcaktuara në nenin 63 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”.

22. Të huajit i anulohet leja e punës, e tipit B/VP, nëse vërtetohet njëra nga situatat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 64 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”.

23. I huaji, të cilit i refuzohet ose anulohet leja e punës, e tipit B/VP, ka të drejtën e ankimit, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 2 të nenit 65 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”.

24. Leja e punës, e tipit B/VP, përfundon, nëse plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 44 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”.

25. I huaji, i cili pajiset me leje pune të tipit B/VP, para marrjes së lejes së punës, detyrohet të paguajë tarifën prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh.

26. Të huajit, të cilit i ripërtërihet leja e punës, e tipit B/VP, para marrjes së lejes së punës detyrohet të paguajë tarifën prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh.

27. Drejtoria, që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, monitoron, në mënyrë periodike, procedurën e ndjekur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrat përkatëse të punësimit, për dhënien e lejes së punës.

28. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrat përkatëse të punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Formular-Kërkesë për Lëshimin e Lejes së Punës

Ju lutemi plotësoni formularin e mëposhtëm për lëshimin e lejes së punës, e cila do t'ju lëshohet, brenda.....ditë pune, nëse përmbushen të gjitha dispozitat e Ligjit.....

Application Form for Issuing the Work Permit

Please complete the following form in order to obtain a Work Permit which will be issued to you within working days, if any of the relevant clauses of the Law..... are fulfilled

SEKSIONI 1. TE DHENA MBI PERSONIN QE PARAQIT KERKESEN SECTION 1. ABOUT THE PERSON SUBMITTING THE REQUEST

Kjo kërkesë paraqitet:

The request is to be submitted:

Personalisht

☐

In person

Nga përfaqësuesi i autorizuar

☐

Authorized Representative

Nga punëdhënësi

☐

Employer

Emri : _____
First Name

Mbiemri : _____
Last Name

Emri i babait : _____
Father's Name

Shtetësia : _____
Citizenship

Jeni shtetas i Bashkimit Evropian?
Are you a national of the European Union

Po ☐ Jo ☐

Datëlindja : _____
(ditë, muaj, vit)

Date of Birth (day, month, year)

Vendlindja : _____
(shteti, rajoni, komuna)
(country, region, commune/province)

Shtetësia : _____
Citizenship

Kombësia (nëse është e rëndësishme) : _____
Nationality (if relevant)

Gjinia : Mashkull ☐ Femër ☐
Gender Male Female

Gjendja civile : I/e pamartuar ☐ I/e martuar ☐ I/e divorcuar ☐
Marital Status : Single Married Divorced

A keni pasur më parë një leje pune shqiptare? Po ☐ Jo ☐
Have you ever been issued an Albanian Work Permit

Telefonë : _____

E-mail : _____
Mailing address

Pasaportë : E zakonshme ☐ Shërbimi ☐ Diplomatie ☐
Passport Ordinary Service Diplomatic

Dokument tjetër udhëtimi i njohur nga Republika e Shqipërisë, si i barazvlefshëm: ☐
Other Travel Documents Recognized by the Republic of Albania

Data e skadimit të vlefshmërisë së pasaportës : _____
Date of Passport Expiry

Lëshuar nga : _____
Issuing authority

Persona në ngarkim në vendin e origjinës:
Family members in charge in the country of origin

Bashkëshort/e ☐ Fëmijë të mitur ☐ Prindër ☐
Spouse Children Parents

Data e hyrjes së fundit në territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes Pikës së
Kontrollit të Kalimit të Kufirit (PKKK) : _____
Last Entry Date to Albania
Through Border Checkpoint

SEKSIONI 2. TE DHENA MBI VIZEN**SECTION 2. VISA DETAILS**

Data e hyrjes së fundit në Shqipëri : _____
Last Entry Date to Albania
Pika e kalimit të kontrollit kufitar : _____
Border Checkpoint
Numri i vizës : _____
Visa Number
Tipi i vizës : _____
Type of Visa
Me një hyrje : _____
Number of Entries (1)
Me shumë hyrje (Multiple) : _____

Shënime/motivi i vizës së hyrjes : _____
Remarks/ Reason/Motive of the Entry Visa
Kohëzgjatja e vizës : _____
Duration of Stay
E vlefshme nga : _____
Valid from
(dita, muaji viti)
(day, month, year)

Deri me : _____
Until
(dita, muaji, viti)
(day, month, year)

SEKSIONI 3- TE DHENA MBI STATUSIN E KANDIDATIT**SECTION 3 - ABOUT CANDIDATE STATUS**

Punëmarrës/e ☐
Employee
Punëdhënës/e ☐
Employer
I/e vetëpunësuar/e ☐
Self-employed
Investitor/e ☐
Investor

SEKSIONI 4-TIPI I KERKESES**SECTION 4- TYPE OF THE REQUEST**

Leje pune fillestare ☐
Initial Work Permit
Ripërtëritje e lejes së punës ☐
Renovation of Work Permit

Azhurnim i lejes së punës ☐

Adjournment of Work Permit

Dublikim i lejes së punës ☐

Duplication of Work Permit

Shndërrim i lejes së punës ☐

Conversion of Work Permit

Data e lëshimit të lejes së parë, apo ekzistuese : _____

Issuing Date of the first, or present Work Permit

(dita, muaji, viti)
(day, month, year)

Data e përfundimit të lejes ekzistuese të punës

Expiry date of the present Work permit

(dita, muaji, viti)
(day, month, year)

SEKSIONI 5....TE DHENA MBI PERSONIN/AT E KONTAKTIT

SECTION 5. CONTACT DETAILS

Telefon : _____

Telephone

Fax : _____

E-mail : _____

Web page : _____

Adresa aktuale : _____

Present Address

Rajoni/Qyteti : _____

Region/City/Town

Post Code/Zip Code : _____

SEKSION 6 -TE DHENA MBI VENDIN E PUNES PER PUNEMARRESIN

SECTION 6- ABOUT THE JOB FOR THE EMPLOYEE

Emërtimi i vendit të punës.

Job Title

Përshkrim i shkurtër i vendit të punës/ Aftësi të përdorura/Përgjegjësi

Short Job Description/Skills Used/Responsibilities

Ndërmarrja që punëson _____

Employing Company _____

Niveli i pages : _____
Salary level

Data e menduar e fillimit të punës : _____
Intended start date of work

(dita, muaji, viti)

(day, month, year)

Data e menduar e përfundimit të punës : _____
Intended finish date of work

(dita, muaji, viti)

(day, month, year)

Shpjegoni shkurtimisht se përse e keni pasur të vështirë të gjeni shtetas shqiptarë, apo rezidentë të huaj, të ligjshëm për zënien e këtij vendi të lirë pune?

Explain shortly why it is difficult to find someone from the resident labor market, or foreign legal resident for this vacancy?

Shpjegoni shkurtimisht se ç'keni bërë për të reklamuar (bërë publik, të njohur) këtë vend pune-

Explain shortly what have you done to publicly advertise this vacancy?

Jepni hollësira mbi njoftimet në internet dhe në median e shkruar, duke përfshirë edhe datat

Details about website and adverts in print publications including dates

Shpjegoni shkurtimisht se si mësuat për vendin e lirë të punës

Explain shortly how did the candidate/employer find out about the vacancy?

(Për punëdhënësin) Shpjegoni shkurtimisht se si e zgjodhët kandidatin punëmarrës
(For the employer) Explain shortly how did you select the potential employee?

☐ Me njohje të drejtëpërdrejtë

By direct acquaintance

☐ Me rekomandim/referim

By recommendation/reference

- ☐ Përmes listave të punëkërkesve pranë Zyrës Rajonale/Vendore të Punësimit
Consulting the lists of jobseekers at various Regional/Local Employment Offices

SEKSIONI 7. TE DHENA PER TE VETEPUNESUARIN

SECTION 7. ABOUT THE SELF-EMPLOYED

Person juridik ☐

Legal person/entity ☐

Person fizik ☐

Natural Person

Lloji i biznesit : _____

Type of Business

Kodi Fiskal/NIPT-i : _____

Fiscal Code/NIPT

Numri i sigurimeve shoqërore dhe data regjistrimit _____

Social Insurance number and Date of Registration

(dita, muaji, viti)

(day, month, year)

Vendimi i gjykatës për njohjen e biznesit, ose _____

Court Decision on Business Acknowledgment or

Ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit _____

Abstract from National Registration Centre

SEKSIONI 8. TE DHENA PER INVESTITORIN

SECTION 8. ABOUT THE INVESTOR

Person juridik ☐

Legal person/entity

Person fizik ☐

Natural Person

Lloji i biznesit : _____

Type of Business

Kodi Fiskal/NIPT-i : _____

Fiscal Code/NIPT

Numri i sigurimeve shoqërore dhe data regjistrimit _____

Social Insurance Number and Date of Registration

(dita, muaji, viti)

(day, month, year)

SEKSIONI 9. TE DHENA TE PUNEDHENESIT

SECTION 9. ABOUT THE EMPLOYER

Person juridik ☐

Legal person/entity

Person fizik ☐
Natural Person

Lloji i biznesit : _____
Type of Business

Kodi Fiskal/NIPT-i : _____
Fiscal Code/NIPT

Numri i sigurimeve shoqërore dhe data regjistrimit _____
Social Insurance Number and Date of Registration
(dita, muaji, viti)

SEKSIONI 10. KUALIFIKIME ARSIMORE: SECTION 10. EDUCATIONAL ATTAINMENT

1. Kualifikime arsimore Educational Qualifications

Diplomë universiteti ☐
University Diploma

Diplomë kolegji ☐
College Diploma

Diplomë ☐
Any Degree
Shkollë teknike ☐
Technical School Diploma

Të përgjithshme ☐
General Education Certificate
Të tjera ☐
Others

2. Kualifikime të formimit profesional Technical/Professional Training Qualifications

Certifikata/Diploma
Certificates/Diplomas

Deklaroj se i lexova dhe rashë dakord (në një mendje) me kushtet për lëshimin e lejes së punës plotësisht i vetëdijshëm për pasojat e paraqitjes të të dhënave të rrema, apo jo të vërteta, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi

I confirm that I have read and agree to the for the issue of the Work Permit well aware of the consequences for submitting false, or no real data, according to prevailing Albanian legislation in force.

Tarifa për përpunimin dhe lëshimin e lejes së punës është....Lekë shqiptarë, siç përcaktohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr....., datë

The cost of processing is.....Albanian currency (Lekë), as determined by the Decision of the Council of Ministers.....

(Emri Mbiemri)

Signature

____/____/200__